



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 13 dhe 15 maj 2019.
2. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.”” (Komision përgjegjës)
3. Shqyrtimi nen për nen i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.””

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Permeti, Edmond Leka, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Xhemal Qefalia dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Bashkim Fino, Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar :

Edis Ibrahimimi – Këshilltar i ministres së Drejtësisë

Artan Syziu – Përfaqësues i Sektorit të Analizës në Ministrinë e Drejtësisë

Amantina Dobi – Eksperte vendase (EURALIUS)

Edlira Osmani – Eksperte vendase (EURALIUS)

Elda Çela – Përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit

Kujtim Luli – Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të datave 13 dhe 15 maj 2019.

Procesverbalet e mbledhjeve ju kanë ardhur në rrugë elektronike.

A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratojen procesverbalet e datave 13 dhe 15 maj 2019.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, te shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore e këtij projektligji është kolegja Elena Xhina.

Siç e dini, kjo paketë ndryshimesh në Kodin Penal është nismë e një grupi prej 11 deputetësh të Partisë Socialiste. Paketa është bërë e ditur për opinionin publik. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Dy komisione të tjera të Kuvendit, Komisioni i Sigurisë Kombëtare dhe Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve janë caktuar si komisione për dhënie mendimi, për shkak se paketa e ndryshimeve në Kodin Penal parashikon edhe një paketë masash penale për sigurinë ushqimore, por edhe për krimet mjedisore.

Gjithsesi, në emër të grupit nismëtar, kolegu Alket Hyseni, që është një nga firmëtarët e këtij projekti, do të bëjë një prezantim se ku konsiston kjo paketë ndryshimesh në Kodin Penal. Më pas do t’ia kaloj fjalën koleges Elena Xhina.

Zoti Hyseni, fjala është për ju.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë dhe të ftuar...

Ulsi Manja – Më falni, zoti Hyseni!

Nga Ministria e Drejtësisë kemi prezentë zotin Edis Ibrahim, këshilltar i ministres, si dhe zotin Artan Syziu, përfaqësues i Sektorit të Analizës.

Nga misioni EURALIUS kemi të ftuar zonjën Amantina Dobi dhe zonjën Edlira Osmani, eksperte vendase.

Nga Prokuroria e Përgjithshme kemi prezent zotin Kujtim Luli, prokuror.

Nga Ministria e Turizmit kemi si përfaqësuese zonjën Elda Çela.

Dua të sjell në vëmendjen e kolegëve që sot, duke qenë prezantimi dhe miratimi në parim i paketës, ne jemi mjaftuar vetëm me njoftimin për orën e zhvillimit të mbledhjes dhe rendin e ditës, sepse në shqyrtimin dhe miratimin nën për nën të ndryshimeve në Kodin Penal, do të ftohen të gjithë aktorët, faktorët dhe ekspertët, për të qenë prezentë në diskutimet që do të bëhen mes relatorit dhe grupit të punës, por edhe në seancë, në Komisionin e Ligjeve. Meqenëse sot jemi vetëm për diskutimin dhe miratimin në parim... Dihet që miratimi në parim është shprehje e vullnetit politik.

Zoti Hyseni, ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen! Mund të vazhdoni.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke pasur diskutime të shumta me grupet e interesit, që i kanë pasur nevojë dhe domosdoshmëri ndryshimet në Kodin Penal, edhe pse është gjykuar se ka nevojë për një ndryshim thelbësor të Kodit Penal, një grup deputetësh i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste vendosi që, në mbështetje të kërkesave të këtyre grupeve të interesit, të mos pritët ndryshimi total i Kodit Penal. Ky kod tashmë kërkon diskutime të thella dhe të zgjeruara dhe, që të mos bëjmë një kod të ri të nxituar, por t'i lihet koha e nevojshme, u mendua të paraqitet kjo paketë e ndryshimeve pjesore në këtë kod për një grup veprash penale, të cilat ne mendojmë se janë domosdoshmëri dhe nevojë imediate për t'u prezantuar dhe për t'u futur në Kodin Penal.

Ne mendojmë se mjedisi, të cilin e kemi ngritur në programet tona elektorale (të gjitha partitë politike në Shqipëri tashmë janë bërë të ndjeshme ndaj çështjeve të mjedisit), kërkon mbrojtje të veçantë. Me një sërë dispozitash në këtë paketë, ne prezantojmë mbrojtjen e veçantë të mjedisit në tërësinë e tij, të zonave të mbrojtura, të florës dhe faunës.

Kanë qenë disa fusha të parregulluara ose të rregulluara jo mirë. Për këtë arsye, ne menduam të prezantojmë çështjet për mbrojtjen e sigurisë ushqimore për konsumatorët.

Ne mendojmë se duhet të kriminalizohet vepra e papërgjegjshme e kujt do që synon të përfitojë në kurriz të shëndetit të fëmijëve tanë, të fëmijëve të shqiptarëve të zakonshëm, qofshin demokratë, qofshin socialistë.

Po ashtu, kanë qenë disa fusha që kërkojnë domosdoshmëri për t'u pasqyruar në Kodin Penal. Për shembull, kemi qenë dëshmitarë që mjekët janë të pambrojtur në veprimtarinë e tyre. Kemi qenë dëshmitarë të disa veprave të dhunshme kundër mjekëve. Për këtë arsye, ne mendojmë se duhet të parashikojmë menjëherë përforsim i sanksioneve penale kundër kujt do që vendos dorë mbi mjekët. Nga ana tjetër, e kemi shoqëruar këtë edhe me rregullimin e

dispozitave të neglizhencës mjekësore, në mënyrë që edhe mjekët të kuptojnë se vërtet shteti do t'i mbrojtë, por edhe detyra e tyre ndaj shqiptarëve duhet të jetë më e përgjegjshme.

Ka qenë edhe shqetësimi i grupit për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve. Ka edhe një iniciativë nga ata, që do të bashkohet gjatë diskutimit për veprat penale për mbrojtjen e kafshëve, bashkë me këtë pjesë të paketës, për të arritur te më e mira.

Ne vendosëm që autoriteti i shtetit duhet të rivendoset menjëherë. Autoriteti i shtetit fillon nga mbrojtja e figurës së çdo zyrtari, që nga nëpunësi më i thjeshtë deri te zyrtari më i lartë i shtetit. Ata nuk mund të lihen në dorën e të papërgjegjshmit, për t'i kanosur, goditur e fyer në mënyrën më brutale të mundshme. Për këtë arsye, janë parashikuar edhe disa vepra për goditjen për shkak të detyrës, ripozicionimi në këtë aspekt, po ashtu edhe për kanosjen.

Pak a shumë, u përpoqa të përmbledh grupin e veprave, pa futur këtu edhe dispozitën për lojërat e palejuara.

Qëllimi është prezantimi në tërësi i kësaj pakete, sepse relatorja do të bëjë një prezantim të thelluar.

Në emër të grupit të përpunuesve të deputetëve të Partisë Socialiste, doja t'i thosha kujtdo që kjo paketë është e lirë për diskutim dhe përmirësim. Ne po hapim sot, sikurse e theksoi edhe kryetari, diskutimet në parim, por kushdo është i ftuar ta përmirësojë këtë paketë, të diskutojë rreth saj për më të mirën e mundshme.

Ju faleminderit!

Ju ftoj për diskutime të frytshme.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Hyseni!

Po, zoti Shameti, keni diçka për të shtuar si nismëtar?

Adnor Shameti –Po.

Argumenti i kolegut Hyseni ishte i plotë dhe përshinte gjithë qëllimet kryesore të nismës ligjore.

Dua të sqaroj, si për kolegët e komisionit, ashtu edhe për gjithë opinion publik, se Kodi Penal, i cili është aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë, është gati 25-vjeçar. Janë bërë ndërhyrje të cekëta gjithë këto vite në Kodin Penal. Sikurse e tha edhe kolegu Hyseni, nuk është koha dhe nuk ekzistojnë kushtet për të bërë një nismë për një Kod të ri Penal, megjithëse mund të jetë e domosdoshme. Kushtet, niveli i sigurisë në vend dhe cenimi i nivelit të sigurisë publike, e ka sjellë si një domosdoshmëri ndërhyrjen në kod dhe prekjen e dispozitave të caktuar të tij. Është çështja e sigurisë publike dhe kombëtare, që i takon mbrojtjes së subjekteve të veçanta, siç janë deputetët, punonjësit e policisë, mjekët, siguria që duhet të ekzistojë në të

gjitha aktivitetet sportive dhe siguria ushqimore, që është e domosdoshme dhe e jashtëzakonshme.

Dua të theksoj edhe diçka, që kolegu Hyseni nuk e përmendi, por që është shumë e rëndësishme. Disa nga këto çështje, të cilat janë prekur te ky bllok dispozitash, që janë sjellë sot për ndryshim në Komisionin e Ligjeve, sikurse e theksova, janë detyrime, që rrjedhin nga cenimi i nivelit dhe i kushteve të sigurisë, por, nga ana tjetër, ka edhe detyrime ndërkombëtare, që rrjedhin nga direktivat e BE-së dhe janë pjesë e ndryshimeve që duhet të bëhen në përafrimin e legjislacionit me Bashkimin Europian. Në këto kushte, paketa që ka të bëjë me sigurinë mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit, në vetvete është *mot a mot* gjuha që rezoluta, direktivat periodike dhe BE-ja, kanë adresuar në drejtim të Shqipërisë (e fundit është ajo e vitit 2016) dhe duhet patjetër të gjejë pasqyrim në ndryshimin e të drejtës së brendshme. Në këto kushte, kjo vjen në harmoni të plotë me frymën dhe linjën e ndryshimeve të tjera.

Është për t'u vlerësuar, sikurse e paraqiti edhe kolegu Hyseni, që në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për herë të parë është ushtruar nisma ligjore e një grupi prej 35 mijë shtetasish, e mbështetur kjo edhe nga shoqata të tjera të mbrojtjes së kafshëve dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në këtë kuptim, kjo është në proces. Sikurse edhe jeni në dijeni, në parim e kemi miratuar këtë nismë. Nismës ligjore për mbrojtjen e kafshëve dhe mbrojtjen nga kafshët, iu bashkua me ndryshimet përkatëse edhe ajo e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë ushqimore.

Në përfundim të këtij diskutimi, si në Komisionin e Ligjeve, si komision përgjegjës, ashtu edhe në komisionet e tjera për dhënie mendimi, dua t'ju siguroj që të dyja këto drafte do të jenë në harmoni me njëra-tjetrën dhe do të integrohen në një draft përfundimtar.

Sërish gjej rastin të falënderoj dhe të vlerësoj nismën e shtetasve apo të subjekteve të tjera, si pjesë e ushtrimit të nismës legjislative në Kuvendin e Shqipërisë!

Në këto kushte, ju ftoj të gjithëve ta mbështesim në parim këtë nismë ligjore të paraqitur nga një grup deputetësh, pasi, realisht, ka ardhur koha për të paraqitur dhe mbështetur ndryshime të tilla.

Faleminderit!

Ulsi Manja –Faleminderit, zoti Shameti!

Po ia kaloj fjalën zonjës Xhina, e cila do të jetë deri në miratimin nën për nën dhe të përgatitjes së raportit për seancën plenare, si relatore e komisionit për këto ndryshime të rëndësishme.

Zonja Xhina, fjala është për ju.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj kolegun Hyseni për shpjegimet për nismën, si dhe kolegun Shameti, sepse e plotësoi më mirë kuadrin e shpjegimeve, përmbajtjen e nismës, qëllimin e saj dhe risitë!

Besoj se këto ndryshime, të cilat propozohen nga kolegët e Komsionit të Ligjeve, që janë shumica e nismëtarëve, adresojnë problematikat e shumta që has shoqëria jonë, siç është mbrojtja e të drejtës së autorit, siguria ushqimore dhe shkelja e rregullave të personave që ushtrojnë veprimtari ekonomike. Realisht, këto janë problematika që i kemi dëgjuar më së shumti kohët e fundit dhe kanë shqetësuar komunitetin. Pikërisht adresimet e këtyre ndryshimeve ligjore u përgjigjen gjithë këtyre shqetësimeve.

Kur vjen fjala për ndryshime në Kodin Penal, jo vetëm unë, por besoj se të gjithë kolegët janë skeptikë, pasi dihet që ky kod është prekur më shumë se kodet e tjera, por duke iu referuar shpjegimeve të nismëtarëve, kuptojmë që është e domosdoshme sjellja në këtë moment e këtyre ndryshimeve, pasi, siç e dimë, është duke u punuar për një Kod të ri Penal. Inkurajoj Ministrinë e Drejtësisë të vazhdojë të punojë akoma më tepër, pasi është e nevojshme dhe e domosdoshme dhe ka ardhur koha të kemi një Kod të ri Penal.

Nga ana tjetër, një nga qëllimet e ligjit penal është jo vetëm ndëshkimi, por edhe parandalimi i veprave penale. Shpresojmë që pasi paketa e ndryshimeve ligjore në Kodin Penal të hyjë në fuqi, të kemi ndjeshmëri të këtyre personave që deri më sot kanë tentuar të kryejnë këto vepra penale dhe kështu të ulët numri i këtyre veprimeve antiligjore.

Është e vërtetë që të gjitha parashikimet ligjore të nismës parashikojnë masa dënimi, që në një farë mënyre mund të konsiderohen të ashpra, por nga ana tjetër alternativa që na sjellin nismëtarët duke pasur edhe dënim me gjobë brenda tyre, në një farë mënyre e lehtëson ashpërsinë e këtyre masave të dënimit.

Projektligji ka nevojë për ndryshime të karakterit formal, pasi ai duhet të sillet me gjuhën dhe terminologjinë e Kodit Penal, si dhe duhet të përshkohet nga e njëjta frymë që përshkon Kodin Penal të sotëm, sepse duhet të vlerësojmë me kujdesin faktin nëse dispozitat e reja që propozohen nga nismëtarët e kanë gjuhën e qartë, me qëllim që të lehtësojmë kuptimin e tyre dhe të mos kemi probleme me interpretimin e këtyre veprave të reja penale.

Nga ana tjetër, duhet t'i kushtojmë vëmendje faktit nëse rrezikshmëria shoqërore e këtyre veprave penale të parashikuara përshtatet me masat e dënimit. Të gjitha këto do shikohen hap pas hapi gjatë shqyrtimit të projektligjit nën për nen.

Siç e theksuan edhe nismëtarët, projektligji është i hapur për ndryshime dhe unë si relatore ftoj të gjithë anëtarët e komisionit, të cilët duan të japin kontributin e tyre për përmirësimin e projektligjit, të japin mendimet e tyre për t'iu nënshtruar më pas diskutimit në grup.

Gjithashtu, ky projektligj u është dërguar për konsultim disa organizatave dhe institucioneve, si Prokurorisë së Përgjithshme, Avokatit të Popullit, OSBE-së, misionit EURALIUS, Komitetit të Helsinkit, Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, si dhe Këshillit të Ministrave. Bashkëpunimi ynë me ta do të jetë i hapur për të përmirësuar akoma më tej projektligjin.

Në këto kushte, duke pasur parasysh faktin që sot jemi mbledhur vetëm për miratimin në parim të projektligjit, sepse më pas do t'i nënshtrohemi shqyrtimit dhe punës për ta përmirësuar projektligjin, ju ftoj të gjithëve ta miratojmë dhe ta kalojmë për punë të mëtejshme në komision.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Përpara se t'ua kaloj fjalën kolegëve për të bërë pyetje për nismëtarët dhe relatorin, dua të bëj me dije kolegët e komisionit dhe opinionin publik që kjo paketë ndryshimesh, që është materializuar nga pikëpamja e Rregullores së Kuvendit nga 11 kolegë të maxhorancës, e ka kaluar fazën e parë të konsultimit përpara draftimit. Në diskutimin e kësaj pakete janë përfshirë disa ministri. Po të shikojmë, propozuesit e paketës për sigurisë ushqimore kanë qenë Ministria e Bujqësisë dhe Agjencia Kombëtare e Ushqimit, kurse Ministria e Mjedisit ka qenë propozuesja kryesore e paketës për sigurinë mjedisore. Adresimi i këtyre çështjeve në Kodin Penal ka qenë pjesë e raportit të Bashkimit Europian të vitit 2016, ku i kërkohej Shqipërisë të adresonte në legjislacionin penal një direktivë të vitit 2008 për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet masave penale. Ka qenë të përfshira Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, kurse grupi i punës ka bërë harmonizimin dhe bashkimin në një draft paraprak të këtyre ndryshimeve që propozohen në Kodin Penal, të cilat sot do t'i miratojmë në parim.

Siç e thanë edhe kolegët e mi, nismëtarët, por edhe relatorja, paketa është e hapur për sugjerime dhe propozime konkrete për ta sjellë në frymën dhe strukturën që ka aktualisht Kodi Penal. Ka pasur diskutime pse duhet të bëhet kjo ndërhyrje në Kodin Penal, ndërkohë që ka lindur domosdoshmëria për të pasur një Kod të ri Penal, sepse i sotmi është i vitit 1995. Personalisht, por edhe nga kolegët është gjykuar që reforma në Kodin Penal është më e thellë sesa kaq, ajo kërkon përfshirjen e një numri faktorësh shumë më të gjerë sesa ky grup pune, si dhe kërkon një kohë relativisht të gjatë në dispozicion për të bërë një Kod të ri Penal. I theksova këto që kolegët e mi t'i kenë në konsideratë gjatë diskutimeve që do të kemi sot.

E fillojmë me pyetje dhe më pas secili prej firmëtarëve, zoti Hyseni, zoti Shameti, zonja Xhina, e të tjerë do të japim shpjegimet përkatëse.

Kështu që, fjala është për kolegët për të bërë pyetje për paketën. Nëse nuk keni pyetje, vazhdojmë me votimin në parim.

E ka kërkuar fjalën për të bërë pyetje zoti Zeneli.

Meqenëse jemi në fazën e diskutimit në parim, mund t'i përmbledhni pyetjet dhe diskutimin bashkë.

Alban Zeneli - Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua të përgëzoj nismëtarët e maxhorancës për këtë nismë ligjore. Çdo nismë ligjore për sigurinë e qytetarëve, sigurinë e pasurisë, mbrojtjen e kafshëve, mbrojtjen e mjedisit dhe për sigurisë ushqimore është shumë e rëndësishme, por unë dhe kolegët e mi të opozitës kemi disa vërejtje. Për të bërë ndryshime në Kod, siç ju të gjithë e dini, duhen edhe votat e opozitës. Të gjithë emrat e nismëtarëve janë pjesë e maxhorancës. Nuk e di si do ta zgjidhni ju këtë problem, në një kohë që ne nuk jemi pjesë e një nisme ligjore kaq të rëndësishme, zoti kryetar.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zeneli!

Fjalën e ka kërkuar për diskutim zonja Hysi

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Unë nuk jam firmëtare e nismës, por dua të falenderoj të gjithë firmëtarët dhe të them që e mbështes nismën sepse adreson një sërë problemesh që shqetësojnë çdo shqiptar. Vlerësoj shumë angazhimin e kolegëve jo vetëm për zgjidhjen e shqetësimeve dhe problemeve të profesionistëve të caktuar, por, mbi të gjitha, për mbrojtjen e sigurisë së konsumatorëve në forma të ndryshme.

Unë kam një pyetje për firmëtarët. Njëkohësisht, do të doja t'i ktheja përgjigje edhe kolegut Zeneli. Ka një diskutim shumë të gjerë për mbrojtjen e fëmijëve nga pasiguria në internet dhe abuzimet me fëmijët. Ka një rekomandim sistematik në kuadër të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, por edhe të Konventës të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimet Seksuale. A është diskutuar mundësia për të bërë disa përmirësime në dispozitat përkatëse për sa i përket pornografinë në internet dhe shfrytëzimit që u bëhet fëmijëve në rrjetet sociale?

Për sa i përket asaj që sugjeroi kolegu Zeneli, çdo deputet është i lirë të marrë nisma ligjore, por në bazë të Rregullores së Kuvendit, si shumica, ashtu edhe pakica kanë të drejtë të ketë relator për të mbështetur propozimet ose të propozojnë përmirësime të tyre. Më vjen mirë që e mbështesni nismën, sepse përtej ndasive politike që mund të kemi, është në interes të qytetarëve, madje është e vonuar për shumë nga çështjet që kanë shqetësuar qytetarët, duke na

përfshirë edhe ne këtu, siç janë; siguria ushqimore, siguria e mjedisit, kontaminimi i tyre për shkak të lëndëve që përdoren apo mënyrës si transportohen lëndët e rrezikshme, si dhe mbrojtja e florës dhe të faunës.

Njëkohësisht, unë vlerësoj shumë edhe atë që tha relatorja, por edhe propozuesi, zoti Hyseni, që edhe nisma e 37 mijë zgjedhësve për mbrojtjen e kafshëve do të bashkohet. Besoj që zoti Shameti, që është relatori i asaj nisme, do të punojë me grupin e punës propozues për t'i bashkuar dhe pasqyruar ato shqetësime..

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka kërkuar zoti Lita dhe pastaj zonja Mara.

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Nisma të tilla duhen përshëndetur dhe janë gjithmonë të mirëpritura. Në rastin konkret mendoj që nevoja e vendit për një Kod të ri Penal, për të cilin të zhvillohet një diskutim i gjerë publik dhe profesional në mënyrë që t'i rezistojë kohës, besoj se është evidente. Praktika e arnimit të ligjeve në Shqipëri duhet të marrë fund. Çdo qeveri në këto 30 vjet ka ndjekur të njëjtën praktikë; rregullime pjesore të ligjeve për t'i kthyer ato në funksion të qeverisjes së momentit.

Edhe pse në propozimin konkret ka nene që duhen rregulluar, pasi janë shumë të ndjeshëm në publik, ata duhet t'i përshtaten kohës. Nuk mendoj se këto nene janë kaq emergjente sa të bëhen me urgjencë, por duhet të bëhen bashkë me Kodin për të cilin vërtet vendi ka nevojë.

Për shembull, nuk e kuptoj pse është kaq emergjent ndryshimi i nenit 293, “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e kuptoj pse duhet kjo urgjencë për këtë arnim.

Në emrin tim, por edhe të kolegëve të opozitës, parimisht jemi kundër.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lita!

Fjalën e ka kërkuar zonja Mara.

Aurora Mara – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Personalisht e mbështes nismën, sepse është jashtëzakonisht e rëndësishme. Jam dakord me zonjën Hysi që ndoshta duhet të ishte ndërmarrë më parë. U bëj thirrje të gjithë

kolegëve të mi që ta mbështesin këtë nismë. Unë e kam lexuar draftin. Puna që duhet bërë është shumë impenjative. Nga të gjithë ne duhet punuar me përgjegjshmëri dhe përkushtim të madh, sepse janë çështje jashtë mase të ndjeshme për publikun dhe që na prekin të gjithëve.

Çështjet janë shumë të rëndësishme, është neglizhenca në trajtimin mjekësor, është siguria ushqimore, janë goditjet për shkak të detyrës, kanosja në detyrë, kështu që duhet të jemi shumë të përkushtuar dhe të përgjegjshëm në punën ndaj këtij drafti. U propozoj të gjithëve të punojmë me përkushtim të madh dhe të angazhohemi jashtë mase, sepse, ndryshe nga kolegu im, unë mendoj se këto ndryshime në Kodin Penal janë emergjente.

Faktikisht, ndryshimi i Kodit Penal nuk është gjë e thjeshtë. Si juristë, të gjithë e dimë sa vështirësi ka dhe sa përkushtim kërkon, por uroj që të gjithë të jemi të përgjegjshëm dhe të punojmë me përkushtim në mënyrë që ta arrijmë sa më shpejtë t'i ndryshojmë këto pika kaq të rëndësishme për sigurinë e qytetarëve.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, zoti Zeneli! Fjalën e ka kërkuar zonja Bode.

Edlira Bode – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Besoj se jam e vetmja mjeke prezente këtu, ndaj do të flas vetëm për pjesën e shëndetësisë. E përgëzoj nismën e kolegëve deputetë, sepse zgjidh problematika në shërbimin shëndetësor të paktën në dy aspekte.

Së pari, në drejtim të dhunës ndaj personelit mjekësor. Nuk po përsëris fjalët e kolegut Hyseni, por dua të them se është shumë e rëndësishme që ne të ashpërsojmë masat ndaj atyre që guxojnë të prekin cilindo pjesëtar të personelit mjekësor, mjek, infermier apo edhe personel mbështetës, kur ata janë duke ushtruar detyrën.

Nga ana tjetër (për t'iu përgjigjur kolegut, i cili thotë pse duhet të ndërhyjmë me urgjencë), urgjenca duhet zgjidhur brenda 24 orëve, kurse emergjenca nuk prek as 24 orë. Ndryshimet që duhen bërë në këtë ligj janë emergjente dhe duhen zgjidhur menjëherë. Duhet ndarë përfundimisht, siç e ndan ky projektligj, neglizhenca mjekësore nga gabimet mjekësore. Duke pasur këtë konfuzion në legjislacionin shqiptar, shumë herë kanë ndodhur edhe arrestime të padrejta të mjekëve, të cilët kanë qenë duke kryer detyrën, e që në 99 % të rasteve kanë rezultuar pastaj të pafajshëm. Ndërkohë, është shumë i rëndë dëmi që u është shkaktuar për arsye të këtij gabimi, e kësaj pasaktësie në legjislacionin shqiptar, për t'i ndarë qartësisht rastet

se kur duhet ndëshkuar mjeku, dhe në rastet kur ndëshkimi qëndron duhet të jetë i Kodit Civil dhe jo i Kodit Penal.

Prandaj uroj që puna për përmirësimin e këtij projektligji të ecë sa më shpejt, sa më mirë, që të paraqitet sa më parë në seancën plenare.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit zonja Bode!

Edhe një herë zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

I nxitur edhe nga çfarë tha kolegja Hysi, mendoj se dy gjëra duhet të kemi parasysh: e para, është emergjente bërja e një Kodi Penal nga fillimi, gjë që me sa dimë, Ministria e Drejtësisë e ka filluar. Unë vë re se të gjitha shqetësimet që trajtohen këtu, te kjo nismë ligjore, janë absolutisht emergjente, po përderisa ka edhe gjëra të tjera emergjente, pse duhet t'i ndajmë? Shumë gjëra që tha zonja Hysi janë emergjente, edhe këto janë emergjente, me përjashtim të nenit 293, që nuk e kuptoj pse është futur aty, sepse nuk është emergjent. Nuk dua të paragjykoj se mund të jetë futur për shkak të situatës të sotme politike, sepse besoj se nuk është ashtu, por është më mirë që gjithë çfarë është emergjente sot në Shqipëri të futet në këtë nismë ligjore, dhe të bëjmë ose kodin ose të gjitha bashkë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Fjalën e ka kërkuar zoti Gjoni. Pastaj zonja Hysi.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë besoj se duhet përshëndetur dëshira për të amenduar Kodin Penal përmes kësaj nisme ligjore, por nuk e kuptoj përse nismat ligjore të Partisë Socialiste shoqërohen gjithnjë nga elementi i nxitimit. Pra, hajde i fusim, që t'i kalojmë sa më shpejt në seancë plenare, pa bërë ndonjë konsultim publik, pa ndonjë debat të madh dhe t'i votojmë, sepse i duhen vendit.

Jam shumë dakord që vendit i duhen masa mbrojtëse, dhe shteti duhet të mbrojë personelin shëndetësor, duhet të mbrojë personat në funksione publike, duhet të mbrojë qytetarët tanë për sa i përket sigurisë ushqimore, por nuk e kuptoj përse kjo nismë po kërkohet të shitet si diçka emergjente dhe si një nismë që duhet kaluar sa më shpejt përmes këtij komisioni, e menjëherë pastaj në seancë plenare.

Doja ta bashkoja mbështetjen time edhe me kolegët e opozitës, për sa i përket nevojës emergjente, do të thosha, të rishikimit të tërë Kodit Penal. Besoj se këtu duhet fokusuar e gjithë puna e këtij komisioni dhe jona si deputet, po kam një pyetje për grupin që e ka propozuar këtë, si dhe për komisionin gjithashtu: a janë marrë masa për sa i përket konsultimit publik? Sepse, një amendim kaq i rëndësishëm i Kodit Penal nuk mund të kalojë me shpejtësi, pa kaluar më

parë përmes fazës së nevojshme të konsultimit publik. Duhet të dalim në bazë dhe të shohim për çfarë ka nevojë popullsia, çfarë duan qytetarët shqiptarë, që ne ta reflektojmë këtu përmes mendimeve ligjore.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Duke qenë se edhe unë jam një nga nismëtarët, e shoh të udhës se ka nevojë për qartësim faza e konsultimit publik.

Zoti Gjoni, faza e parë e konsultimit publik në lidhje me këtë paketë ndryshimesh në Kodin Penal, është ezauruar. Më lejoni të sjell në vëmendje se pjesa që ka të bëjë me dhunën në sport ka një tryezë të konsultimit publik, të organizuar me Federatën Shqiptare të Futbollit, që është publike. Pra, Kryeministri dhe të gjithë aktorët e përfshirë në këtë diskutim, nisur nga shqetësimet që kishte Federata Shqiptare e Futbollit, është organizuar një tryezë e konsultimit publik, dhe dispozitat që propozohen janë të konsultuara e të propozuara edhe nga vetë federata.

Dhuna ndaj mjekëve, në lidhje me të cilën, me të drejtë zonja Bode theksoi se paketa sjell depenalizimin e gabimit mjekësor, por penalizon neglizhencën. Ka një tryezë të organizuar me mjekët, madje dy tryeza, thotë zonja Bode. Pra, edhe për këtë pjesë të paketës është kryer faza e parë e konsultimit publik.

Lidhur me sigurinë ushqimore, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për këtë paketë ndryshimesh që propozojnë, prej më se një viti kanë qenë të pranishëm në tryezën e konsultimit publik, brenda për brenda institucionit. Ka pasur disa kontakte me Këshillin e Ministrave, por edhe me Komisionin e Ligjeve e me Kuvendin, që paketa e sigurisë ushqimore të adresohet me kohë.

Pra, nuk është se kjo paketë ndryshimesh ndodhi në vakuum. Ka një fazë të parë të konsultimit publik. Sot nisma është materializuar në Kuvend, dhe nismëtarët: zoti Hyseni, zoti Shameti, por edhe kolegë të tjerë, e theksuan: ne jemi të hapur, kjo paketë është e hapur për diskutim.

Sot jemi në miratimin në parim, por faza e shqyrtimit dhe e miratimit nen për nen do të marrë gjithë kohën e nevojshme. Absolutisht që ne jemi koshientë për këtë. sa herë bëhen ndryshime në Kodin Penal, ndërhyrjet janë delikate, ndaj do të duhet të jepet koha nevojshme për konsultim publik me ekspertët e fushës, por dhe çdo deputet dhe koleg i pozitës e i opozitës. Sepse ne jemi koshientë për faktin se, që kjo të kalojë në seancë plenare, kërkon shumicë e cilësuar. Pra, duhen 84 vota. Kështu, pa votën e kolegëve të opozitës, ne nuk mund ta kalojmë dot këtë paketë ndryshimesh në Kodin Penal. Në fund fare, është Komisioni i Ligjeve vendi ku

do ta zhvillojmë këtë fazë të konsultimit publik, sepse pjesë e konsultimit të gjerë publik janë edhe dy komisionet e tjera të Kuvendit: është Komisioni i Sigurisë, që po shqyrton këtë paketë ndryshimesh në Kodin Penal, dhe ky komision ka ekspertizën e nevojshme për pjesën që ka të bëjë me sigurinë dhe rendin publik. Një pjesë e kolegëve të Komisionit të Ligjeve janë po ashtu edhe anëtarë në Komisionin e Sigurisë, kështu që i kanë të gjitha mundësitë të japin kontribut në lidhje me atë pjesë të paketës. Po ashtu, është Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, në fushën e përgjegjësisë së të cilit është Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. E ka në komision, si komision për dhënie mendimi. Në Konferencën e Kryetarëve është vendosur përsëri që Komisioni i Shëndetësisë të jetë komision për dhënie mendimi.

Pra, jemi katër komisione, që do të marrim në shqyrtim e në miratim nen për nen paketën e ndryshimeve në Kodin Penal, secili sipas fushës së ekspertizës që ka. natyrisht. Në finale, si komision përgjegjës që është, Komisioni i Ligjeve do të hartojë edhe raportin për seancën plenare.

Kësisoj, unë mendoj se janë të gjitha mundësitë që ta përmirësojmë këtë draft. Në Komisionin e Ligjeve mund të kemi, pse jo edhe dy bashkërelatorë. Edhe opozita është e hapur që ta caktojë një bashkërelator. Ne si shumicë kemi relatore zonjën Xhina. Kolegët e opozitës mund ta caktojnë sot një relator, kështu që të mund të kemi dy bashkërelatorë. Pra, opozita i ka të gjitha mundësitë dhe instrumentin për të qenë pjesë dhe për t'u përfshirë në diskutimin e kësaj pakete.

Faleminderit!

Po, zonja relatore!

Elena Xhina – Ju falënderoj, zoti kryetar!

Unë e përmenda edhe në fjalën time, se jemi të hapur, unë personalisht, por edhe nismëtarët, bashkë me të gjithë kolegët. Është fat i mirë që unë jam e pavarur si deputete, dhe në njëfarë mënyre mund të bashkëpunoj me secilin nga ju, pa pasur frikë nga politika. në këto kushte, unë jam e hapur që, me gjithë kolegët e opozitës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Ulsi Manja – Ju lutem, ju lutem, le ta mbarojë fjalën zonja Xhina.

Elena Xhina – Pra, në fjalën time, se kështu ndodh sa herë që nuk jemi të vëmendshëm ndaj fjalës së tjetrit, përmenda edhe konsultimet që janë bërë me grupet e interesit, me ministritë e linjës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elena Xhina – Unë do t'ju lë mundësinë juve që ta testoni se çfarë ishte kjo, kemi kohë ta shohim përfundimin. Megjithatë, këtë po thosha, se ju ftova të gjithëve që të jepni propozimet dhe amendimet tuaja. Do të zhvillohen tryeza bashkëbisedimi, në të cilat ne do të shprehim e do të shqyrtojmë mendimet e njëri-tjetrit. Kështu që, kemi kohë, nuk ka asnjë ngut. Askush nuk e thotë se kjo duhet shqyrtuar e përfunduar brenda një kohe limit. Kohën e kemi përpara dhe mund të japim mendimet më të mira.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Po, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mbështes sugjerimin tuaj, zoti kryetar, por do të doja të sillja në vëmendje për ju, zotin Lita, si dhe për zonjën Bushka, ndonëse nuk është sot, se në bazë të nenit 29 të Rregullores, kryetari i komisionit, në këshillim edhe me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e komisionit, nisur nga rëndësia që ka çështja që shqyrtohet, cakton më shumë se një relator.

Edhe në përvojën tonë, kur këtë komision e ka drejtuar opozita, unë shpesh kam qenë relatore së bashku me kolegë të maxhorancës, të cilët sot janë në opozitë. Kjo është gjë shumë e mirë, pasi i jepet gjithë vëmendja e duhur.

Gjithashtu, zoti Alimadhi, meqenëse kjo është nismë e deputetëve të Partisë Socialiste, unë nuk e kam pranuar sugjerimin e bërë, për të qenë relatore e këtij ligji jo pse nuk e dua, është edhe në fushën time, por mendova se relatorët duhet të ishin deputetë të grupeve të tjera parlamentare, që kanë përvojën e duhur, sikundër është edhe zonja Xhina, e cila ka një përvojë relativisht të gjatë si në gjyqësor, si në mësimdhënie, por që ka edhe profesionalizëm. Angazhimi i deputetëve të tjerë, përfshirë edhe mua, nuk do të mungojë, me qëllim që të bëjmë më të mirën.

Unë do t'ju sugjeroja që, si kryesi, ju të propozoni një relator, për të punuar së bashku, sepse të gjitha ndryshimet në Kodin Penal, edhe në 2012-ën, edhe në 2013-ën, janë bërë bashkërisht. Është diçka delikate. Është ajo që thanë zoti Lita dhe zoti Gjoni, ndryshimet në Kodin Penal janë ndryshime që nuk bëhen shpesh, po kur bëhen duhet të jenë të menduara mirë dhe të konsultuara. Ne do t'i mirëpresim edhe mendimet e komisioneve të tjera, por unë do të doja, zoti kryetar, se kur të vijnë edhe opinionet e institucioneve shtetërore e të shoqërisë civile, tek të cilët ju e keni shpërndarë draftin, t'u shpërndahet të gjithë deputetëve e të punohet në grupe pune, para se të fillojë diskutimi nen për nen.

Por unë ju them se këto ndryshime janë të vonuara. Po, ka edhe shumë të tjera që mund të bëhen, por minimumi, Kodi Penal do pesë vjet. Në rast se do të flasim për një Kod të ri Penal, të cilin unë e kam kërkuar vazhdimisht, e kemi trajtuar edhe në reformën në drejtësi, minimumi do pesë vjet. Duhet bërë konsultim i gjerë publik, nëse do një Kod Penal, i cili të qëndrojë për njëzet, tridhjetë apo dyzet vjet. Ai ka filluar, e ka filluar qeveria, dhe nuk është detyra jonë. Të paktën, ne t'i përgjigjemi sigurisë ushqimore të qytetarëve.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka kërkuar zonja Mara. Pastaj do të kalojmë në votimin në parim.

Aurora Mara – Jam dakord me zonjën Hysi: ndryshimi i Kodit Penal do vite e vite të tëra pune e përkushtimi. Më shumë për kolegët e mi të opozitës, dua ta theksoj se këto janë çështje jashtëzakonisht emergjente, madje jetike për popullin tonë.

Edhe një herë i falënderoj shumë iniciuesit e draftit. E para, t'i cilësosh çështjet si emergjente nuk do të thotë të evitosh procedurat, për të arritur në ndryshimin e draftit. Të punosh me emergjencë do të thotë t'i japim rëndësi pikave që kemi prekur në draft, dhe jo të evitojmë procedurat, punën e përkushtimin.

Jo rastësisht e përmenda përgjegjshmërinë, sepse duhet të jemi të gjithë të përgjegjshëm, të gjithë sa jemi ulur në këtë tavolinë, në lidhje me këto pika që prek me të vërtetë ndryshimi i draftit. Ky është tamam ai moment, kur duhet t'i kalojmë ato problematikat opozitë-pozitë, është momenti kur duhet të punojmë të gjithë së bashku, me përgjegjshmëri e përkushtim, në lidhje me këto pika që na prekin ne të gjithëve dhe të gjithë opinionin publik.

Ne, si deputetë, duhet të jemi të përgjegjshëm, dhe përgjegjshmëri do të thotë ta kalojmë atë limitin e opozitës e të pozitës, pra të mendojmë vetëm për interesin publik.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

Fjalën e ka kërkuar zoti Zeneli, e më pas zoti nënkryetari i komisionit. Pastaj do të kalojmë në votimin në parim.

Alban Zeneli – Faleminderit!

Ndoshta është pak jashtë kësaj nisme, por unë e theksova qëparë edhe për një arsye tjetër faktin se duhen 84 vota. Mandatin e kaluar unë kam qenë pjesë e komisionit të sigurisë. Përvoja dhe praktika e atij komisioni, në kohën kur ju ishit përsëri në maxhorancë, ishte se asnjë nismë ligjore nuk është ndërmarrë nga opozita. Kjo jo për faj të opozitës, por sepse kështu ishte ajo praktika juaj e famshme. Uroj që gjithçka që ju thoni këtu, në këtë komision, të mos

jetë thjesht një hipokrizi ndaj qytetarëve shqiptarë. Ne do të jemi absolutisht dakord, që të marrim pjesë në nisma ligjore, të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjala për zotin Lita, si kryetar komisioni. Ndoshta zoti Lita ka edhe ndonjë propozim konkret.

Korab Lita – Jo, unë e mbështes parafolësin, si dhe juve, sa i takon diskutimit rreth faktit se mund të marrim pjesë, por i drejtohem parafolëses, Aurorës, që unë asnjë çast nuk thashë se s’janë të rëndësishme, sepse sigurisht, jam shumë koshient që janë të rëndësishme. Unë evidentova vetëm një nen, edhe për ta ilustruar pak, meqenëse ajo e bëri shumë shumë emergjente. Unë nuk e kuptoj sa emergjente është shkelja e rregullave të mbajtjes së kafshëve të shoqërimit. Nuk e di, domethënë, ne gjithmonë kemi mbajtur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, ju lutem!

Korab Lita – Gjithmonë kemi mbajtur kafshë. Ekziston rreziku, por s’është emergjente, se s’po përmbysen dynjaja.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lita!

Kolegë, ju kërkoj vëmendje, sepse do të kalojmë në votimin në parim.

Unë ju falënderoj për të gjitha diskutimet konstruktive!

Faza e miratimit në parim hap tiparin e diskutimit të kësaj pakete gjatë ditëve e javëve në vazhdim. Unë e mirëpres sugjerimin e koleges Hysi, që në zbatim të nenit 29 të Rregullores, opozita të ketë një relator, së bashku me zonjën Xhina. Nuk e di sa është e mundur, por unë shpresoj ta kemi që sot një propozim konkret, për ndonjërin nga kolegët e opozitës që janë të pranishëm këtu. Natyrisht, nëse do të bini dakord të keni një bashkërelator, do të duhet të jetë i përkushtuar për ta bërë si duhet këtë punë, sepse pas miratimit në parim, grupi i punës do të mbledhet gati çdo ditë. E rëndësishme është se të dyja palët biem dakord në një pikë: çështjet që adreson kjo paketë masash penale, janë çështje jetike në kuptimin e problematikës, që kërkojnë t’i japin mbrojtje të posaçme juridiko-penale. Për shembull, sot dhe këtu do ta mbyll, çështjet e sigurisë ushqimore dhe të sigurisë mjedisore, trendet e legjislacioneve moderne bashkëkohore, në Europë kanë filluar t’i shohin si çështje të sigurisë kombëtare. Dhe janë çështje të sigurisë kombëtare, sepse kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të qytetarëve shqiptarë.

Ju e dini se ka një natyrë veprash penale, që vrasin çdo ditë e nga pak, ndaj mbase jemi ët vonuar në adresimin e këtyre shqetësimeve.

Gjithsesi, të nderuar kolegë, unë dua ta hedh në votim në parim.

Kush është dakord në parim, me ndryshimet që propozohen?

Pro? Kundër 4. Asnjë abstenim.

Miratohet projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27. 1. 1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, nismë deputetësh.

Shumë faleminderit për votën, të nderuar kolegë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sipas Rregullores, shpjegim vote nga zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – E dini pse votova kundër, zoti kryetar? Sepse kjo fjala “burg” na ka shoqëruar gjithmonë, ndaj jam shumë i kujdesshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjala “burg” historikisht na ka rënë neve, ndërsa ju zakonisht keni bërë ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Burgun e kemi pësuar ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Historikisht, po them.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Alimadhi!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.””

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Permeti, Edmond Leka, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Xhemal Qefalia dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Bashkim Fino, Fatmir Xhafaj, Damian Gjijnuri, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Ulsi Manja – Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës, e cila është po kaq e rëndësishme sa ajo që sapo kaluam, ndaj kërkoj vëmendjen e kolegëve.

Jemi në shqyrtimin nën për nën të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16. 12. 2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar””.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore është kolegja Hysi.

Ftoj Shërbimet e Kuvendit, që janë marrë me projektvendimin, që të zënë vend të pjesa e të ftuarve.

Kemi kaluar disa nene të kësaj rregulloreje. Në mos gaboj, zonja Hysi e kemi lënë në neni 6, të cilin nuk e kemi votuar. E kemi lënë të hapur, ashtu siç i kemi lënë të hapura edhe disa nene të tjera të Rregullores së Kuvendit.

Edhe një herë të nderuar kolegë, para se të fillojmë me shqyrtimin dhe me miratimin nën për nën të Rregullores po ripërsëris të njëjtën gjë. Nenet për të cilat kolegët kanë propozime konkrete dhe riformulime për pjesë të caktuara të tyre, do të lihen të hapura. Para votimit në tërësi ne do t'i adresojmë nenet e Rregullores për të cilat qoftë kolegët e maxhorancës, qoftë ata të opozitës kanë sugjerime dhe propozime konkrete. Kështu zonja Hysi, për eficiencë pune në komision, do t'ju kërkoja si relatore t'i linim ato nene, të cilat nuk janë mbyllur dhe të vazhdojmë me shqyrtimin e neneve për të cilat është mbyllur diskutimi. Të njëjtën gjë do të kërkoja edhe nga përfaqësuesit e shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Zonja Hysi, për nenin 6.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Neni 6 do të lihet i hapur, pasi duhet verifikuar bazuar në propozimin që bëri zoti Fino. Llojet e raportimeve që duhen bërë në Kuvend.

Nga ana tjetër, do të bëhet një konsultim nga të gjithë drejtorët e drejtorive të Kuvendit së bashku me raportin e IPA-s për të parë nëse mund të shmanget ndonjë raport, sepse deri tani të gjitha raportet që citohen në nën, janë raporte të miratuara, ka vendime të Kuvendit dhe nuk na mundësohet neve, si komision të marrim kompetencat e organeve të tjera, që i kanë miratuar.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, ndihuni të lirë për të bërë komente dhe propozime. Edhe unë kam amendamente për këtë projektligj. Dokumenti që keni përpara është një dokument pune, që nuk është prekur as nga unë si relatore, sepse unë kam respektuar propozimet dhe opinionet që kanë bërë kolegët e opozitës në komision. Ata nuk janë më deputetë, por për respekt të punës 2-vjeçare që është bërë së bashku me ta, ato janë lënë ashtu sikurse janë rekomanduar. Ndaj, në Komisionin e Ligjeve ne bëjmë riformulime. Është e drejta

jonë që në bazë të Rregullores së veprimtarisë së komisionit dhe të mandatit që kemi si deputetë, të diskutojmë dhe të bëjmë formulimet përkatëse.

Ulsi Manja – Zoti Zeneli ka një pyetje.

Alban Zeneli - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Hysi!

Ju thatë se ky draft që është paraqitur këtu, ka qenë i dakordësuar me deputetët e opozitës që ishin në parlament?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Zeneli!

Drafti nuk është dakordësuar totalisht, sepse kemi qenë një grup pune, i cili nuk arriti dot ta finalizonte, ta pastronte draftin për ta kaluar me konsensus. Ka qenë fundi i dhjetorit dhe u shty për në janar. Ju e dini se çfarë ndodhi më pas, por unë e kam lënë siç ishte në respekt të të gjithë punës së bërë. Besoj se kjo është një punë gati 2-vjeçare.

Përveç kësaj, ne kemi të drejtë si deputetë, të japim mendime.

Lidhur me nenin 7, që sjell ndryshime në nenin 12, “Konferenca e Kryetarëve” zoti kryetar, është një propozim për pikën 2, që vjen nga stafi i Kuvendit që ka qenë pjesë e grupit të punës dhe adreson një shqetësim që është hasur shpesh në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve. Kur mungon kryetari i komisionit mbledhjen mund ta drejtojë zëvendëskryetari. Kur mungon kryetari i Kuvendit, njëri nga zëvendëskryetarët bën mbledhjen. Pra, nuk ka pse të bllokohet veprimtaria. Prandaj janë edhe zëvendëskryetarët.

Të nderuar kolegë, unë kam bërë një riformulim të përmbajtjes së nenit në fjalë. Më lejoni ta lexoj: “Konferenca e Kryetarëve përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët e Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare ose në mungesë të tyre zëvendëskryetarët”. Kjo është pjesa e shtuar.

“Konferenca e Kryetarëve drejtohet nga Kryetari i Kuvendit, ose në mungesë të tij nga zëvendëskryetari. Konferenca e Kryetarëve thirret nga Kryetari i Kuvendit, ose me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose nga një kryetar i një grupi parlamentar.

Në Konferencën e Kryetarëve merr pjesë edhe anëtari i Këshillit të Ministrave, i ngarkuar të mbajë lidhjet me Kuvendin.”

Ky është riformulimi. Pra, është dhënë mundësia që organet e Kuvendit të funksionojnë.

Ulsi Manja – Ky është neni 7.

Zoti Alimadhi e do fjalën për nenin 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, a mund ta ndizni mikrofonin?

Adriatik Alimadhi – Mos është e nevojshme të shihet pak kjo, sepse thirret nga Kryetari? Dakord, po përbërja e kësaj strukture a duhet të ketë një të drejtë?

Vasikila Hysi – E ka përbërjen.

Adriatik Alimadhi - Dakord për përbërjen, por thirrja. Mendoj se duhet të ketë një sens.

Vasilika Hysi – Faleminderit zoti Alimadhi!

Në titullin e dispozitës thuhet “Konferenca e Kryetarëve” dhe është Kryetari i Kuvendit që drejton Konferencën e Kryetarëve. Po të shihni nenin tjetër, aty marrin pjesë Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët e Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare, kryetarët e komisioneve të përhershme dhe kjo konferencë drejtohet nga Kryetari i Kuvendit. Risia është se, në mungesë të tij mund ta drejtojë zëvendëskryetari, ose, nëse mungon një kryetar komisioni, risia është që do të shkojë zëvendëskryetari i komisionit. Vetëm ky është ndryshimi, pjesa tjetër është siç ka qenë në rregullore.

Adriatik Alimadhi – Nuk e kam se kush e drejton, por duke parë që përbërja e Konferencës është e gjerë dhe që ka dy mundësi, opozitë dhe maxhorancë, thirrja duhet të ketë një ndikim. Për shembull, nga eksperiencat e subjekteve politike, në rastin konkret, kur ne mbledhim Këshillin Kombëtar thuhet: “Në bashkëpunim me kryetarin e Këshillit Kombëtar”.

Vasikila Hysi – Shumë faleminderit! Ndoshta unë e lexova shpejt, por thuhet: “Konferenca thirret nga Kryetari i Kuvendit ose me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose një kryetar i grupit parlamentar”, pra varet nga problematika që ka.

Ulsi Manja – Duhet ta mbledhë menjëherë.

Vasilika Hysi – Konferenca mbledhet menjëherë dhe i vetmi ndryshim është parashikimi i zëvendëskryetarëve, sepse nuk mund të pezullohet ecuria e punimeve të parlamentit kur një kryetar është me shërbim jashtë vendit, apo mund të jetë më leje shëndetësore atë ditë. Aktiviteti i Kuvendit duhet të vijojë.

Ulsi Manja – Po, zoti Qefalia, për nenin 7.

Xhemal Qefalia – Zonja Hysi, në mbështetje të zotit Alimadhi, ndoshta ai ka parasysh që në seancat dëgjimore nëpër komisione, kur nuk e thërret kryetari dhe sekretari, 1/3-ta e anëtarëve të komisionit kanë të drejtë ta thërrasin dhe ndoshta ka parasysh këtë moment.

Vasilika Hysi – Në rast se kemi parasysh kompetencat që ka Konferenca e Kryetarëve, ajo miraton programin dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit të Shqipërisë, ndërsa çdo deputet ka të drejtën e vet të thërrasë komisione apo nënkomisione, por jo të bëjë të gjithë kalendarin e Kuvendit dhe të flasë në emër të 140 deputetëve.

Ulsi Manja – Po zoti Hyseni.

Alket Hyesni – Propozim për formulim.

Në parim jam totalisht dakord, e ka tregua koha që ky parashikim, apo ky ndryshim i ri në nenin 12 është domosdoshmëri, por duhet të bëjmë një veçanti për Kryetarin e Kuvendit. Ndryshe nga komisionet ku ka një nënkryetar, Kuvendi mund të ketë 2 ose 3 zëvendëskryetarë, nuk ka një kufi. Për këtë arsye ndryshimi që propozoj është: “Konferenca e Kryetarëve drejtohet nga Kryetari i Kuvendit, ose, në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari i deleguar nga Kryetari”, sepse nuk mund të jetë çdo zëvendëskryetar, pasi do të lindë konflikt në terren. Mund të jenë 40 zëvendëskryetarë dhe secili prej tyre mund të pretendojë të drejtë mbledhjen. Ne duhet ta themi se cili nga zëvendëskryetarët mund ta drejtojë mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka më të madhe së Konferenca e Kryetarëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo nuk është shkencë se nuk po shpikim gjë. Nëse mungon titullari kryesor, në vend të tij vjen me delegim zëvendëskryetari. Kjo është teoria e së drejtës, të mos bëjmë shpikje, këtu nuk ka asnjë hile, se ndonjëherë opozitave u duket sikur bëhet hile. Ne thjesht po themi: që të mos pritet që sa të vijë Kryetari nga një shërbim jashtë vendit, i cili mund të jetë me ndonjë delegacion dhe mund të ndodhë që Konferenca e Kryetarëve duhet të mbledhet urgjent, atëherë zëvendëskryetari mbledh Konferencën, por shqetësimi që kam është nëse janë dy e më shumë, zëvendëskryetar, të delegohet kjo.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Hyseni!

Ky problem është zgjidhur në Rregullore, e delegon zëvendëskryetari i grupit më të madh parlamentar. Nëse edhe ai nuk është, siç ka ndodhur, e drejton zëvendëskryetari tjetër. Në përgjithësi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E ke te neni për zëvendëskryetarët.

Alket Hyseni – Për teknikë legislative, këtu po flasim për Konferencën e Kryetarëve dhe duhet ta rregullojmë. Çfarë të keqe ka? Konferenca e Kryetarëve drejtohet nga Kryetari i Kuvendit ose zëvendëskryetari i deleguar prej tij dhe pikë. Kjo është teoria e ligjit. Nëse ju e fusni në një nen tjetër, është tjetër gjë.

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, ju lutem!

Vasilika Hysi – Në nenin 9 të Rregullores së Kuvendit, që titullohet “Zëvendëskryetarët e Kuvendit”, thuhet: “Zëvendëskryetarët bashkëpunojnë me Kryetarin e Kuvendit për realizimin e detyrave të Kryetarit. Ata thirren për këshillim nga kryetari sa herë

shihet e nevojshme. Në rast se Kryetari mungon ose është në pamundësi të kryejë detyrat e tij, ai autorizon një nga zëvendëskryetarët për kryerjen e tyre...”.

Ulsi Maja – E ka neni 9 i Rregullores.

Vasilika Hysi – “...Në mungesë të autorizimit ai zëvendësohet nga Zëvendëskryetari i Kuvendit që i përket shumicës parlamentare”. Pra, është nen i veçantë, që rregullon ...

Ulsi Manja – Shqetësimi i zotit Hyseni është i drejtë, sepse janë tre nënkryetarë dhe nuk mund të lihet në bllok, pa u përcaktuar, por fakti që neni 9 nuk do të preket, është e rregulluar.

Në nenin 7, që ndryshon nenin 12, propozohet riformulimi në kuptimin që Konferenca drejtohet nga Kryetari dhe kur mungon Kryetari, neni 9 autorizon një nga nënkryetarët, dhe kur mungojnë kryetarët e komisioneve të përhershme të Kuvendit, do të shkojnë nënkryetarët. Ky është ndryshimi që propozohet.

Vasilika Hysi - Po.

Alket Hyseni – Ka ndodhur që opozita, në të kaluarën, e ka interpretuar Rregulloren ndryshe, duke thënë se ligjvënësi, po të kishte vullnet, do ta kishte parashikuar në dispozitën konkrete. Ky ka qenë debati. Dispozita konkrete është kjo, nuk është ajo. Ajo është për kompetencat e zëvendëskryetarëve, të mos e ngatërrojmë. Kjo është Konferenca e Kryetarëve. Janë dy gjëra të ndryshme dhe unë nuk e kuptoj çfarë na kushtonte ne për të thënë “me autorizim”. Këtu po flasim për një kompetencë të qenësishme të Kryetarit të Kuvendit, jo një kompetencë rëndom të ...

Ulsi Manja – Mund të bëj një propozim konkret, që ta kalojmë këtë pikë?

Konferenca e Kryetarëve drejtohet nga Kryetari i Kuvendit ose në mungesë të tij nga zëvendëskryetari, sipas parashikimeve të nenit 9 të Rregullores. Neni 7 lidhet me nenin 9.

Kush është dakord me nenin 7, edhe sipas propozimit për shtesën? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 8, që ndryshon nenin 13 të Rregullores.

Vasilika Hysi – Neni 8 ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Të nderuar kolegë, neni 8 është ndryshuar në bazë të nevojës për ta saktësuar me Kushtetutën, konkretisht me nenet 69, 71 dhe 73. Këto kanë ardhur si propozime të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Njëkohësisht, pikat e tjera të këtij neni janë rishikuar nga stafi i Kuvendit dhe nga ne relatorët.

Të nderuar kolegë, unë kam bërë një riformulim nga pikëpamja e teknikës legislative të projektit që ju keni përpara, por edhe një plotësim të kompetencave që ka Këshilli.

E para, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin është këshillimor dhe kryen funksionin e vlerësimit, dhënies së mendimit për çështje të procedurave për funksionimin dhe vendimmarrjen e Kuvendit. Unë e kam riformuluar, duke shtuar në draftin që ju keni, se ky Këshill ka kompetencë të shprehet për propozimet për ndryshimin e Rregullores; për interpretimin e Rregullores; për interpretimin e Kodit të Sjelljes dhe udhëzuesit e Kodit të Sjelljes, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Sjelljes dhe në këtë Rregullore; për vlerësimin periodik dhe rishikimin e Kodit të Sjelljes, që është një kërkesë tjetër e Kodit të Sjelljes; për konfliktet për kompetencat ndërmjet komisioneve dhe çështje të tjera të parashikuara nga kjo Rregullore.

Nëse do të më lejoni, kryetar, unë dua ta lexoj riformulimin, sepse e kam bërë pothuajse në tërësi.

Pika 2 riformulohet si më poshtë: “Këshilli është organ këshillimor, i cili vlerëson ose jep mendim për çështje që kanë të bëjnë me:

- a. Propozimin për ndryshimin e Rregullores.
- b. Interpretimin e Rregullores, sipas parashikimeve në nenin 116 të saj.
- c. Interpretimin e Kodit të Sjelljes dhe udhëzuesit e Kodit të Sjelljes, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Sjelljes dhe në këtë Rregullore.
- ç. Vlerësimin periodik dhe rishikimin e Kodit të Sjelljes në rastet e parashikuara në Kodin e Sjelljes.
- d. Konfliktet në lidhje me kompetencat ndërmjet komisioneve.
- e. Çështje të tjera të parashikuara nga kjo Rregullore.

Pika tjetër: “Këshilli shqyrton kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin, heqjen e lirisë në çfarëdo formë, ushtrimin e kontrollit personal ose të banesës së ndonjë deputeti, sipas rregullave të parashikuara në nenet 118 dhe 119 të kësaj Rregulloreje”.

Më parë në Rregullore ne kemi parashikuar edhe dhënien e autorizimit për ndjekjen penale. Sot çdo deputet ndiqet pa marrë autorizim. Pra, në këtë pikë është hequr fjalia që i kërkohet Kuvendit të autorizojë ndjekjen penale. Çdo deputet ndiqet pa marrë autorizim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mbaroj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta lexoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër.

Këshilli shqyrton rastet e pazgjidhshmërisë, sipas nenit 69 të Kushtetutës, si dhe bën verifikimin e mandatit të deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës kur krijohet vakancë mbi bazën e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Shërbimet e Kuvendit kanë kërkuar për të detajuar çfarë thonë nenet 69 dhe 70 të Kushtetutës dhe kemi pasur një diskutim me zonjën Pano nëse duhet ta themi në mënyrë të detajuar apo jo. Këtë pyetje e kam edhe për ju, të nderuar kolegë dhe ju, zoti kryetar. A do ta riformulojmë në mënyrë të detajuar, të themi se Këshilli shqyrton të gjitha rastet e pazgjidhshmërisë të parashikuara në nenin 69 të Kushtetutës, çështjet e vlefshmërisë së mandatit të deputetit, që lidhen me fillimin dhe mbarimin e ushtrimit të mandatit, heqjen dorë nga mandati, kushtet e papajtueshmërisë, sipas nenit 70 të Kushtetutës, mungesën pa arsye për më shumë se 6 muaj rresht në Kuvend. Stafi ka shtuar diçka, që unë nuk e kam të qartë se çfarë kanë dashur të thonë me fjalët: “Dënimi i deputetit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi”. Pra, ka dy mundësi: të themi “Shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me pazgjidhshmërinë, sipas parashikimeve të neneve 69 dhe 70 të Kushtetutës” ose të hyjmë në mënyrë të detajuar.

Të nderuar kolegë, një ndryshim tjetër është se ne nuk kemi pasur afate. Kemi pasur një afat 30-ditor, ndërkohë, nga stafi, por edhe nga përvoja, është sugjeruar që Këshilli paraqet raportin përkatës në seancë plenare jo më vonë se dy javë nga përfundimi i shqyrtimit. Pra, është shkurtuar, jo 1 muaj.

Njëkohësisht, është zgjidhur edhe problemi çfarë ndodh kur në mes të ushtrimit të mandatit, të legjislaturës, krijohet një vakancë. Këshilli verifikon mandatin e deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës, kur krijohet vakancë, mbi bazën e vendimit të Komisionit të Zgjedhjeve dhe paraqet raportin përkatës në seancë brenda dy javëve. Aktualisht e kemi brenda 30 ditëve, por besoj se është shumë kohë e gjatë dhe mund të lihet brenda dy javëve.

Gjithashtu, një pikë tjetër e këtij neni është: “Këshilli mbledhet me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit”. Kolegët e stafit kanë shtuar: “Ose të opozitës parlamentare me rend dite të përcaktuar. Diskutimi i çështjeve në Këshill bëhet në mënyrë të parashikuar nga kjo Rregullore për komisionet e përhershme. Kur nuk arrihet konsensusi për çështjet objekt-shqyrtimi, shumica dhe opozita parlamentare i paraqesin Kuvendit në seancë raporte të veçanta”.

Kam disa pyetje për ju, të nderuar kolegë, dhe për zonjën Pano dhe zonjën Arbri.

E para, pse stafi i Kuvendit e ka parë të nevojshme të detajojë çfarë thonë nenet 69 dhe 70 të Kushtetutës?

E dyta, çfarë keni dashur të thoni me fjalinë “Dënimin e deputetit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi”, që është shtuar?

E treta, nuk e di arsyeën pse thuhet që Këshilli mund të mbledhet edhe me kërkesë të opozitës parlamentare dhe, nga ana tjetër, thoni që Këshilli vepron sipas rregullave të komisionit, kur në komision, 1/3-a e deputetëve do të thërrasë mbledhjen e komisionit. Kështu që, mund të ndodhë që edhe 1/3 e deputetëve, anëtarë të Këshillit, mund të thërrasin mbledhjen e Këshillit. Nëse duam t’i referohemi.

Ulsi Manja – Po, zonja Pano.

Mimoza Pano – Faleminderit, zoti kryetar!

Për sa i përket pyetjes së parë, kemi menduar që dispozita e Kushtetutës të transpozohet në dispozitën e Rregullores së Kuvendit. Kemi menduar të bëjmë detajimin dhe t’u referohemi rasteve siç i përmend Kushtetuta. Në këtë kuptim është edhe dënimi me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, që është një nga rastet e mbarimit të parakohshëm të mandatit të deputetit dhe që e parashikon Kushtetuta. Domethënë, nuk kemi futur asgjë të re, por thjesht janë rastet. Do të jetë vlerësimi juaj nëse do ta lëmë me raste të veçanta apo do ta referojmë te nenet e Kushtetutës.

Për sa i përket pikës 6 dhe propozimit që ka bërë stafi i Kuvendit për këtë formulim, kemi pasur një problem shumë të madh, sepse Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, por edhe Këshilli i Legjislacionit janë organe këshillimore, që përbëhen nga numër të barabartë deputetësh, të maxhorancës dhe të opozitës, pesë anëtarë nga opozita dhe pesë anëtarë nga maxhoranca.

Kjo pikë e nenit të Rregullores aktuale referonte në mbledhjen e Këshillit sipas rregullave për komisionet parlamentare, por në ndryshim nga komisionet parlamentare, që pasqyrojnë raporte përpjestimore sipas rezultateve të zgjedhjeve të fundit, këshillat bëjnë një ndryshim dhe kjo gjë ka shkaktuar ngërç. Ka pasur shumë raste që nuk është arritur të mbledhet as Këshilli për Legjislacionin dhe as Këshilli për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin, sepse duheshin të paktën gjashtë anëtarë.

Duke qenë se maxhoranca kishte pesë anëtarë dhe vullnetin për ta mbledhur, kurse opozita nuk paraqitej, atëherë mbledhja dilte e pavlefshme. Realisht nuk janë bërë mbledhje, përjashtuar rastet e veçanta të Këshillit të Mandateve kur kemi bërë verifikim mandati për deputet në rast vakance. Kur nuk është arritur të plotësohet numri, është referuar të votohet në seancë plenare për raportin që ka prodhuar Këshilli i Mandateve.

Në këto kushte, ne menduam që diskutimet të bëhen, por mbledhja të zhvillohet edhe me pesë anëtarë. Është vlerësimi juaj si do ta vendosni. Kjo ka qenë arsyeja.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Pano!

Unë jam dakord me sugjerimet e kolegut Hyseni në mbledhjen e parë, por edhe që ne nuk kemi ngutje për Rregulloren e Kuvendit. Edhe unë kam sugjerime konkrete për këtë nen. Këtu ka kolegë me eksperiencë parlamentare më të madhe. Rregullorja është procedurë dhe ka nene ku përmbajtja e dispozitës konkrete të Rregullores involvon edhe aktorë të tjerë. Për shembull, neni 13 ka Gjykatën Kushtetuese në mes. Për sa kohë, në instancë të fundit, për cilëndo nga llojet e formave të përfundimit të mandatit të deputetit, do të shprehet Gjykata Kushtetuese, unë nuk e shikoj të udhës që ky nen i Rregullores të detajohet në këtë standard. Për mendimin tim mjafton pika 2, kurse te pika 3, në vlerësimin tim dhe siç e propozoj unë, është e panevojshme të ndërhyhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Moza, të mbaroj unë, sepse, me aq eksperiencë sa kam, të jesh e bindur që e njoh Rregulloren.

Pika 4, “Këshilli shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me mandatin e deputetit dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare”, nuk ka nevojë të detajohet. Pse i duhet thënë Këshillit të shqyrtojë çështjet që lidhen me fillimin, mbarimin e mandatit, apo heqjen dorë? Këto janë në Kushtetutë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos më ndërprisni! Kam marrë pjesë minimalisht në 30-40 mbledhje të Këshillit të Mandateve dhe e di se ku çalon punë në atë Këshill.

Për mendimin tim, në këtë nen duhet të rregullohet shkurtimi i afatit në pikën 5, nga 30 në 2 javë. Çështjen kur jemi pesë me pesë dhe kur njëra palë nuk vjen në mbledhje, jo më kot Rregullorja e referon në seancë plenare. Ajo është organi që e zgjidh. Këto janë organe *ad hoc* të Kuvendit. Seanca zgjidh. Atje është sovrani. Nëse nuk vijnë pesë anëtarë, pesë anëtarët e tjerë prodhojnë raportin përkatës dhe ia dërgojnë seancës. Ky është propozimi im.

Së dyti, unë mendoj që në fund të pikës 6 të shtohet ky paragraf: “Kur nuk arrihet konsensusi për çështjet objekt shqyrtimi, shumica dhe opozita i paraqesin Kuvendit raporte të veçanta.” Mund të mblidhet Këshilli për Mandatet dhe Rregulloren me të gjithë anëtarët, por nuk ka dakordësi për çështjet objekt shqyrtimi. Këtë e kemi bërë deri tani, por nuk ka qenë e shkruar në Rregullore. Pjesa tjetër e detajimeve që keni bërë te pika 3 dhe pika 4 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Personalisht mendoj që janë detajime të panevojshme. Mendoj që Këshilli i Mandateve dhe Rregullores është një stacion kur shqyrton çështjet e imunitetit. Është KQZ-ja,

Këshilli i Mandateve dhe Rregullores, është Kuvendi dhe Gjykata Kushtetuese në instancë të fundit.

Zonja Hysi, unë mendoj të mos e mbingarkojmë, por të zgjidhim çështje që na kanë dalë nga praktika. Për shembull, duke qenë pesë me pesë dhe nuk vjen njëra palë, atëherë do të mblidhet Këshilli i Mandateve dhe Rregullores dhe pala që është prezente do të bëjë një raport duke i thënë seancës plenare që mendimi im si shumicë për çështjen objekt shqyrtimi është ky, është ky raport, kurse pala tjetër nuk ka ardhur. Le të vendosë seanca plenare.

Në pikën 6 të saktësohet e drejta me dy raporte. Kjo ka në konsideratë situatën kur Këshilli mblidhet, por ka ndarje. Për sa i përket pjesës tjetër më duket se do të hyjmë në detaje të panevojshme. Le të jetë pika 4. Këshilli shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mandatin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Megjithatë, unë kam propozimet e mia që do t'i bëj edhe konkretisht.

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Shumë faleminderit!

Zonja Hysi, unë kisha diçka për pikën 1, përbërjen e Këshillit.

Për shembull, zonja Xhina është e pavarur. Po nga deputetët e pavarur nuk do të ketë anëtarë, sepse situatat politike ka prodhuar shumë të pavarur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mendoj që duhet t'u jepet mundësia për të qenë pjesë e Këshillit edhe deputetëve të pavarur.

Ulsi Manja - Po, zoti Gjoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gjoni, të kërkoj ndjesë! E kishte zoti Hyseni fjalën.

Alket Hyseni – Zoti kryetar, mesa po shoh, po shkojmë drejt lënies hapur së kësaj dispozite.

Do t'i ftoj të gjithë kolegët të bëjnë propozime me shkrim, që të mundësojmë një formulim korrekt. Momenti i rëndësishëm, që duhet të shtrojmë për diskutim dhe të ftojmë gjithsecilin për propozime, është funksionimi i këtij këshilli. Herë pas here praktika ka sjellë që këshilli të mos ketë vendimmarrje. Nuk ka organ që ndërtohet për të mos marrë vendime. Duhet të kuptojmë teorinë e së drejtës. Një organ ndërtohet për vendimmarrje, jo për të mos marrë vendime. Këtu biem ndesh edhe me formulimin. Kur themi “për sa është i mundur krijimi i tij në paritet”, kjo nuk do të thotë se edhe vendimmarrja duhet të jetë në paritet. Tek e fundit, çdo vendim, që del nga ky këshill, shkon përsëri në seancë. Ne duhet të përcaktojmë modalitetin

e funksionimit të këtij këshilli. Nëse nuk vjen gjysma, a vlen mbledhja? Po flasim për funksionimin, për vlefshmërinë e vetë mbledhjes. Këtë duhet ta rregullojmë.

Së dyti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, ta mbaroj! Të lutem, se m'u ndërpre mendimi...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Shtypeni mikrofonin, zoti Alimadhi, që fjalët tuaja të fiksohen si rekorde!

Alket Hyseni –Ja, se po e mbaroj.

Unë jam dakord me propozimin e zotit Alimadhi, që, nëse do të kemi një ndarje të prerë pozitë-opozitë, një ditë të bukur mund t'i lëmë jashtë loje këta deputetë të pavarur, jo vetëm sot që mund të jenë 1,2 apo 5, por edhe më shumë. I bie që këta deputetë të pavarur të mos kenë akses në disa nga organet e rëndësishme të komisionit. Mund ta përcaktojmë këtë. Ky mund të jetë një element i mirë për funksionimin, i cili nuk e kushtëzon politikisht, që, nëse maxhoranca ose opozita nuk do të vijë, nuk bëhet mbledhja e këshillit.

Prandaj, ju ftoj ta diskutoni me vëmendje këtë.

Nga ana tjetër, për teorinë e ndërtimit të një norme, e para, pika 1 nuk mund të jetë përbërja e organit. Këtë e keni shabllon në Rregullore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është një gabim total. Objekti i ligjit është tjetër gjë, jo se si është organi që zbaton ligjin. Ju e dini këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pika 2 duhet të jetë dhe duhet ta ruajmë kudo, se kjo teknikë është. Nuk ka rëndësi...

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – E ndryshojmë kudo, prandaj po e bëjmë. Ne po bëjmë një Rregullore...

Ulsi Manja – Ju lutem, nëse te nenet ku do të ndërhyjmë mund të bëjmë rregullime të teknikës legislative dhe ndryshime paragrafësh, këtu nuk ka asgjë të keqe, absolutisht!

Alket Hyseni - ...se e nisim gabim komplet.

Nga ana tjetër, jam dakord me kryetarin. Nuk duhet të jemi shumë të detajuar.

E kuptoj që një rregullore mund të përfshijë edhe shumë aspekte të parashikuara në Kushtetutë, në ligj e të tjera, por duhet të jemi të qartë. Ato gjëra që Kushtetuta i ka të qarta, nuk ka nevojë t'i rendisim përsëri. Nëse është domosdoshmëri, kërkon sqarim procedural dhe Kushtetuta e rendit si pikë, por nuk jep procedurën, atëherë ne duhet ta bëjmë këtë. Pra, jo

thjesht të bëjmë shkëputje mekanike, të transpozojmë një dispozitë... Nëse do ta transpozojmë dispozitën, duhet ta transpozojmë të plotë, t'i ruajmë formën dhe të kemi parasysht edhe teknikën, por jo ta themi me fjalët tona dispozitën e Kushtetutës. Kjo është e pakonceptueshme!

Këto kisha si...

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zoti Gjoni e ka kërkuar fjalën për këtë nen. Mesa duket, do të mbetet e hapur edhe kjo.

Zoti Shameti, të lutem!

Ralf Gjoni - Faleminderit, zoti kryetar!

Shqetësimi i ngritur nga zoti Alimadhi për pjesëmarrjen e deputetëve të pavarur, jo të grupit të pavarur, por atyre realisht të pavarur nga një grup parlamentar, në organe të tilla, është i vlefshëm, por ka një problem praktik, zoti kryetar.

Në kuptim juridik, grupet parlamentare janë baza e organizimit të parlamentit në çdo vend demokratik perëndimor. Është normale që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Ulsi Manja – Ju lutem!

Ralf Gjoni - Zoti Alimadh, prit! Më lejo ta...!

(Diskutime pa mikrofon)

Jua thashë edhe një herë, është e vlefshme...

Ulsi Manja – Më falni, kolegë!

Zoti Gjoni, a mund t'ju ndërpres pak?

Kjo është një mbledhje komisioni, e thirrur me rend dite. Kjo nuk është mbledhje e një grupi pune deputetësh apo e një grupi pune të caktuar për ndryshimet në Rregullore. Por për shkak të natyrës që ka diskutimi dhe për shkak se Rregullorja është libra i rregullave, në bazë të së cilave funksionon Kuvendi i Shqipërisë, pra organizon edhe punën tonë të përditshme, unë, në bashkëpunim me relatoren, zonjën Hysi, si dhe me kolegët e grupit të punës, kam thënë: “Po, meqë nuk e kemi me ngut, ta shtrojmë këtë diskutim edhe në komision”. Unë mund ta ndërpres mbledhjen e komisionit dhe të them: “Siç jemi, si grup, të ulemi dhe të punojmë”, por nuk ka asgjë të keqe ta vazhdojmë këtë debat në komision, për aq kohë sa ne mund të kalojmë 2-3 nene, të cilat janë dakordësuar.

Kështu që të kërkoj ndjesë për ndërprerjen, zoti Gjoni!

Ralf Gjoni – Ju falënderoj!

Po e vazhdoj mendimin. Situata politike që po kalon Shqipëria dhe Kuvendi i Shqipërisë në këto momente, është e paprecedentë. Kjo është e qartë për secilin prej nesh dhe për çdo qytetar shqiptar. Disave prej nesh, që ndoshta jemi futur më parë se ata që erdhën më pas, na është dashur të krijojmë fraksione apo grupime parlamentare për të shtyrë para agjenda të caktuara politike, që na bashkojnë ose nuk na bashkojnë.

Ka një problem praktik, zoti Alimadhi. Në emër të kujt dhe kush do të përzgjidhet nga këta deputetë të pavarur, për të marrë pjesë në këto organe kaq të rëndësishme të Kuvendit? Në një grup parlamentar, që e kemi krijuar ne, nëse dikush kërkon të jetë pjesë e një organizmi, grupi merr një vendim. Po në emrin tuaj, nëse...?

Të nderuar kolegë, ju lutem, mbani pak qetësi! Është etikë pune.

Ulsi Manja – Mund të mbaroni, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Nëse sot kemi, ta zëmë, 15 deputetë të pavarur dhe të 15 këta duan të jenë pjesë e këtij organi. Kush e vendos këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem! E kanë kërkuar të gjithë fjalën.

Zoti Alimadhi, e keni edhe një herë fjalën për këtë nen. Më pas do të flasë zonja Mara.

Adriatik Alimadhi – Shoh se kur preket pak individ, në rastin konkret po flasim për një deputet, dhe kur thuhet “të sigurojë një përfaqësim të barabartë”, mendoj se ia heqim të drejtën një deputeti të pavarur. Kjo është pjesa e parë.

Për pjesën e dytë duhet të bëj pak një replikë me zotin Gjoni. Unë e shoh se si funksionon ky parlament. Kam gati dy muaj që jam pjesë e këtij parlamenti. Mënyra e të bërit të grupit shpejt e shpejt prodhoi diçka të çuditshme. Pra, ata morën disa funksione, zëvendëskryetarë apo kryetarë grupesh, dhe asgjë tjetër. Unë nuk e di nëse janë në opozitë apo çfarë janë... Pra, diçka na prodhoi.

Si do ta bëjmë këtë?

Nuk e di nëse këta janë apo jo në opozitë, por ama vendet në parlament i zunë. Mënyra e të shpejtuarit prodhon diçka tjetër. Nuk duhet të shpejtojmë.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Alimadhi!

Fjalën e ka zonja Mara.

Aurora Mara –Faleminderit, kryetar!

Unë do ta shtjelloj çështjen në një sens tjetër. Është e vërtetë që parlamenti funksionon me grupe parlamentare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është mënyra klasike e funksionimit të parlamentit. Eksperienca ka treguar që, përveç grupeve parlamentare në parlament bëjnë pjesë edhe deputetët e pavarur dhe kjo gjë i jep mundësinë dhe pavarësinë çdo deputeti që, nëse nuk ndihet mirë, qoftë edhe në grupin e vet parlamentar, të zgjedhë të rrijë veç për shkak të ideve, të vizionit të tij, apo të problemeve që mund të ketë në grup. Domethënë, ndarja e një deputeti nga grupi parlamentar nuk duhet të jetë një penaltet për atë deputet që të mos marrë pjesë në asnjë komision, nëpër delegacione, si dhe t'i hiqet e drejta që ia jep të qenit deputet. Pra, ai është një deputet si gjithë të tjerët dhe, automatikisht, duhet të trajtohet si të gjithë deputetët e tjerë, pavarësisht se është një grup parlamentar apo jo. Deputeti i pavarur duhet të ketë të gjitha të drejtat nga fillimi deri në fund si të rrijë në një grup parlamentar, si të dalë prej tij.

(Ndërhyrje pa mikropfon)

Ulsi Manja - Prit, ta mbarojë zonja Mara!

Aurora Mara – Më fal, zoti kryetar, sa për nenin 8, që po shqyrtojmë, unë mendoj që në pikën që thotë: “Mandatet më tej përbëhet nga 10 deputetë të emeruar nga Kryetari i Kuvendit, pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare...” këtu të shtohet “deputetë të pavarur”, në mënyrë që të sigurojmë përfaqësim të barabartë në shumicën e opozitës parlamentare”.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

Një sekondë, zoti Përmeti!

Kolegë, po flasim për Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Zotërinjtë Çyrbja dhe Shameti, nëse doni mund të largoheni, nuk ka problem. Koncepti i rregullores dhe i këtij neni flasin për grupet parlamentare, ndërsa për sa u përket të drejtave, janë tjetër gjë të drejtat që ka një deputet i pavarur në Kuvendin e Shqipërisë dhe tjetër gjë përkatësia apo qenia në përbërje të Këshillit të Mandateve dhe Rrregullores. Këtu mund të bëjë sens pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare ose të grupimit parlamentar të deputetëve të pavarur. Gjithmonë do të duhet të ketë një grupim, sepse në Kuvend mund të ketë 10 deputetë të pavarur, ndërkohë që Këshilli për Mandatet dhe Rregulloren ka një përbërje me 10 anëtarë. Si do ta zgjidhim situatën në rast se 20 deputetë të pavarur, të paorganizuar në një grupim parlamentar, kërkojnë të kenë përfaqësim në Këshillin për Rregulloren dhe Mandatet? Prandaj Rregullorja iu është referuar grupeve parlamentare dhe kur ka një grupim tjetër parlamentar të organizuar në një grupim parlamentar, siç është grupimi i deputetëve të pavarur, se sot ka një grup parlamentar të deputetëve të pavarur, mund të vlejë si koncept, por përsëri vlen grupi parlamentar.

Ralf Gjoni – Në mbledhjen e kaluar sugjerova që të përcaktohet me rregullore edhe organizimi i grupeve të interesit parlamentar, pra një grup deputetësh edhe duke qenë ose jo pjesë e një grupi parlamentar, mund të organizohet për të shtyrë përpara një çështje të caktuar dhe në emër të këtij grupimi mund të konsultohet dhe t’i merret parasysh mendimi.

Mendoj se kjo është e mundur.

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Përmeti, më pas zonja Pano, pasi ky është propozim që vjen nga shërbimet e Kuvendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, zoti Përmeti!

Unë nuk e kontrolloj mbledhjen kush ngre dorën dhe ndoshta është defekti i shërbimeve të Kuvendit, por teknologjia e re që keni mbi tavolinë funksionon duke ndezur dritën. Kjo tastjera ime ka butona dhe mund ta shtypin njëkohësisht tri deputetë, por ajo më përcakton radhën se kush e ka shtypur i pari.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ky është faji i shërbimeve të Kuvendit. Teknologjia e re që kemi në dispozicion nuk funksionon më me ngritjen e dorës, por kur shtypin butonin 3 deputetë mua me ndizen 1, 2, 3, 4 dhe them e ka ndezur zoti Hyseni dhe pikë.

Mund të vazhdoni, zoti Përmeti!

Andi Përmeti – Zoti kryetar, si fillim, unë jam deputet i pavarur, kam ndenjur jashtë grupeve parlamentare, por duhet të bashkohem me mendimin e zotit Gjoni se parlamentarizmi funksionon në bazë të grupeve parlamentare dhe çdo deputet merr pjesë në komisione dhe ka të gjitha benefitet që kanë deputetët e tjerë, por pozicionet drejtuese normalisht duhet të jenë më përfaqësuese që janë grupet parlamentare. Në momentin që 20 deputetë të pavarur, duke më përfshirë edhe mua, nuk biem dakord, atëherë nuk mund të përfaqësojmë nëkryetarë nënkomisionesh dhe pjesë të Këshillit të Mandateve dhe Rregullores. Kështu që grupet parlamentare duhet të kenë përparësi dhe kjo është logjika e të qenit në demokraci.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Xhina.

Ju kërkohet ndjesë që jua dhashë me vonesë fjalën!

Elena Xhina – Unë dua të vijoj logjikën e seancës së kaluar për Rregulloren. Unë fola për deputetë jashtë grupeve parlamentare, pasi nuk njihet termi “deputet i pavarur” për sa i përket Rregullores, pra duhe ta themi “deputet jashtë grupeve parlamentare”. Unë kërkova në këtë Rregullore që të përcaktoheshin si pjesë të grupeve të miqësisë, apo të delegacioneve, pra nuk bëhet fjalë për organe vendimmarrëse dhe drejtuese të Kuvendit. Në këto kushte, unë

vazhdoj të mbështes idenë e zotërinjve Gjoni dhe Përmeti, kështu që, ne si deputetë jashtë grupeve parlamentare, nuk kemi pretendime të bëhemi pjesë e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ju lutem, Alimadhi!

Zonja Hysi, për nenin 8, që të mos e vazhdojmë me këtë diskutim...

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Ju lutem, të nderuar kolegë! Unë prisja që zoti Shameti ta merrte fjalën për procedurë. Zonja Hysi, duke marrë në konsideratë sugjerimin që bëni, unë propozoj që mbledhja e komisionit të ndërpritet dhe ky grup deputetësh që jemi këtu ta vazhdojmë konsultimin dhe diskutimin për nenet e Rregullores, që të kemi një produkt të dakordësuar për ato nene, për të cilat do të biem dakord dhe për ato që nuk do të biem dakord dhe që shkojnë në frymën e diskutimeve që e kanë rregulloret e parlamenteve ku duam të shkojmë, të funksionojë mekanizmi i votës, por të ketë një formulim të saktë. Nuk e di a kam mirëkuptimin tuaj për ta ndërprerë mbledhjen, sepse mbledhja është zyrtare dhe e hapur, me qëllim që grupi i punës të mbledhet si grup teknik dhe ta vazhdojmë diskutimin e draftit?!

A jeni dakord?

Dakord.

Atëherë e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme, duke e lënë diskutimin e pikës së tretë, që është shqyrtimi dhe miratimi nen për nen i projektvendimit për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë”, të ndryshuar”, për ditët në vazhdim. Ndërkohë grupi i punës, sapo ta mbyllim mbledhjen, të qendrojë në këtë tryezë. Grupin e punës e drejton relatorja, e cila sipas Rregullores merr të gjitha sugjerimet dhe propozimet konkrete të kolegëve.

Këtu e mbyllim mbledhjen.

Deputetët të mos largohen!

Shumë faleminderit!

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA